

# PER PUNËTORËT E KOOPERATIVAVE QE PUNOJE NE SEKTORIN E PERBERJES SE MISHIT DHE TE SALUMIT

**Lufta jonë, protestat e tona dhe greva jonë nuk janë kundër jush, por për ju!**

Prej disa vitesh në ndërmarrjet e përpunimit të mishit është bërë e zakonshme kalimi gjithmonë e më shumë të punëve me sipërmarrje nga kooperativat. Përse ky fenomen?

Arsyeja është shumë e thjeshtë: **PËR TË SHPENZUAR MË PAK, NË DËM TË PAGESËS SË PUNËTORËVE, NË DËM EDHE TË PAGESËS TËNDE.**

Të nisim me mënyrën e pranimit në punë, këta punëtorë janë bashkëortakë të kooperativave që i marrin në punë, po sa janë të informuar se çdo të thotë bashkëortak? TI e di ç'të drejta e ç'detyra ke si bashkëortak i punës?

- 1) kooperativa mund të vendosi të të paguaj më pak nga ç'është parashikuar nga kontratat nazionale të punës;
- 2) ndodh që për të qënë bashkëortak të mbahet një kuotë nga paga;
- 3) mund të pushohesh nga puna më lehtësisht se një punonjës i zakonshëm.

Ne duam që TI të kesh të njëjtat të drejta me punëtorët e tjerë të ndërmarrjeve që përpunojnë mishin: të drejtën për të punuar të paktën 40 orë të garantuara në javë, një muaj leje të paguar, 108 orë pushime të paguara, një deri në dy paga plus në vit, e parapaguar nga ndërmarrja dhe 100% paaftësia e përkohëshme për shkak të sëmundjeve dhe aksidenteve në punë, të paguhen orët jashtë orarit.

Mos harro pastaj një tjetër formë kursimi perverse, **KURSIMI NË MASAT E SIGURIMIT NË PUNË.**

Gjithmonë e më shpesh punëtorët e kooperativave janë subjekt i fatkeqësive edhe të rënda, kjo nuk është e pranueshme më, të shkosh të punosh nuk do të thotë të mos jesh i sigurt ndaj rrezikut. (të shkosh të punosh nuk do të thotë të vësh në rrezik jetën tënde.)

Ne iu themi **JO SIPËRMARRËSVE JO LIGJOR** sepse reduktojnë të drejtat e të gjithëve e sidomos të TUAT dhe ato të punëtorëve të kooperativave, **BETEJA JONË NUK ËSHTË KUNDËR TEJE**, po një luftë që duam ta bëjmë ME TY për të garantuar të drejtat e të gjithëve.

E dimë që për ty dhe kolegët e tu nganjëherë është e vështirë të luftoni për të drejtat tuaja, për raprezaljet (dëmet) që mund të pësonit; për këtë të kërkojmë të bashkohesh me ne për të njëjtën betejë. **BASHKË JEMI MË TË FORTË!** Drejtoju Organizatave Sindikaliste FAI CISL, FLAI CGIL o UILA UIL për të pasur të gjitha informacionet për të cilat ke nevojë.

**Ftojmë ju dhe kolegët e tu të ngriheni në greve me të gjithë punëtorët e tjerë të këtij sektori ditën e premte për të gjithë ditën me 22 qeshor 2007.**

**Gjithashtu në të njëjtën ditë ju lutemi të merrni pjesë në manifestacionin që do të zhvillohet në orën 9.30 në piazzën Papa Giovanni XXIII ( piazza monumentale afër derrit ) në Castelnuovo Rangone**

**FAI CISL**

**FLAI CGIL  
MODENA**

**UILA UIL**

